



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 716 Prot.

Tiranë, më datë 13.07.2020

VENDIM

Nr. 200, datë 02.07.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 02.07.2020,

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin “Dizenjimi për rivitalizimin e Sheshit “Çerçiz Topulli” dhe parkimin nëntokësor, në Pazarin e Vjetër të Gjirokastrës”, kërkesë e AADF-së me projektues “Dea Studio” dhe MVM architecture, të risillet projekti me plotësimet si në vijim:
 - Të merret në konsideratë varianti i dytë;
 - Të rrallohen harqet në murin Verior të parkimit;
 - Të eliminohen disnivelet (shkallarja) në sheshin “Çerçiz Topulli”;
 - Të eliminohet konfiguracioni i rrethrotullimit dhe të ritrajtohet shtrimi në hyrje të sheshit “Çerçiz Topulli”;
 - Të paraqitet propozimi për planin e mobilitetit gjatë fazës së zbatimit të punimeve.
2. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

